

**V E N D I M**  
**Nr. 438, datë 15.9.1999**

**PËR RRIJTJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË TEKSTEVE TË  
ARSIMIT SHKOLLOR, PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7851, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Çmimet e shitjes me pakicë të librave, të arsimit parauniversitar të rriten, mesatarisht, 15-20 për qind kundrejt çmimeve të tyre me pakicë, në fuqi, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 591, datë 8.9.1998 “Për rritjen e çmimeve të teksteve të arsimit shkollor, parauniversitar”.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të llogarisë çmimet e reja të këtyre librave dhe t’i shpallë ato për zbatim, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi. Këto çmime të zbatohen për të gjithë librat shkollorë të arsimit parauniversitar, që janë në qarkullim dhe që vazhdojnë të shtypen.

Diferenca ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme për sasitë që janë gjendje, pranë subjekteve shtetërore, përkatëse të shitjes me pakicë, dhe të shtypura të derdhen, detyrimisht, në Buxhetin e Shtetit.

Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës që, në bashkëpunim me organet përkatëse të pushtetit vendor, të ndjekë dhe të marrë masat e nevojshme për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, për sistemimin e diferencave të çmimeve dhe për derdhjen e tyre në Buxhetin e Shtetit, gradualisht me shitjen me çmime të reja të librave shkollorë që janë gjendje.

Diferencat ndërmjet shpenzimeve të prodhimit e të shpërndarjes së librave shkollor të arsimit parauniversitar dhe çmimeve përkatëse me pakicë, të caktuara sipas këtij vendimi, të vazhdojnë të subvencionohen nga Buxheti i Shtetit, sipas shumës përkatëse, të miratuar në Buxhetin e Shtetit.

Efekti financiar, prej 20 milionë lekësh të përdoret: 10 milionë lekë të derdhen në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave dhe 10 milionë të përdoren për plotësimin e nevojave të arsimit me tekste.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të nxjerrë udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

Propozimi është që çmimet e shitjes me pakicë të teksteve të arsimit parauniversitar të rriten në masën 15 – 20 % kundrejt çmimeve në fuqi.

Për të krijuar një mbi këtë ngritje çmimesh që propozohet, po japim disa shembuj konkretë:

TITULLI	Klasa që e përdor	ÇMIMI	
		Është	Bëhet
Abetare	I	70	80
Fletore e klasës së parë	I	30	40
Edukata shoqërore 1	I	60	70
Matematika 1	I	70	70
Gjuha shqipe 2	II	60	70
Leximi 2	II	60	70
Matematika 2	II	70	70
Matematika 3	III	70	70

Matematika 4	IV	70	70
Histori e kohës së re 2	X	65	80
Hyrje në filozofi	XII	80	100
Fizika 4	XII	70	90
Kimia 11	XI	75	90

Ngritja e çmimeve që propozohet në total ka një efekt ekonomik prej rreth 20 milion lekë.

Realizimin e sa kërkohet e gjykojmë të domosdoshme të bëhet, mbasi me të, me fondet e dhëna nga buxheti në formën e diferencës së çmimit, pritet një situatë relativisht më e mirë në pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.

Në projekt janë marrë parasysh vërejtjet dhe propozimet e bëra nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë.